



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2020:056774  
Datë: 21.03.2025  
Numri i dokumentit: 07024561

Ac.nr.3441/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Halide Reka, kryetare e kolegjit, Naime Ahmeti dhe Adnan Konushevci, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Xhennet Shantir , në çështjen juridike kontestimore të paditëses N.B nga Gjilani, rruga “M.I”, Nr\*\*\*, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Fadil Sinanaj, avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit, Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Burim Maliqi, zyrtar i lartë ligjor pranë të njëjtës, me objekt të kontestit kompensim i shpenzimeve të ushqimit, udhëtimit dhe shpërblimit jubilar, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.\*\*\*\*/20, të datës 01.03.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 19.03.2025 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET si e pa themeltë ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit, Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.\*\*\*\*/20, i datës 01.03.2022, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.\*\*\*\*/20, të datës 01.03.2022, në pikën I (një) të dispozitivit e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses N.B nga Gjilani dhe e ka detyruar të paditurën Komuna e Gjilanit, Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, që paditëses t’ia paguaj shumën totale të hollave prej 2,237.72 €, dhe atë: - në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit gjatë punës për periudhën prej datës 18.04.2017 deri me datën 11.03.2020, për 539 ditë pune të pranisë në punë te e paditura nga 2.00 € në ditë, shumën prej 1,078.00 €. – në emër të shpenzimeve të rrugës për periudhën prej datës 18.04.2017 deri me datën 11.03.2020, për 539 ditë pune me nga 0.70 € në ditë, pra 70% sipas çmimit të biletës së autobusit e cila ka vlerën 1.00 €, shumën prej 528.22 €, dhe – në emër të kompensimi të shpërblimit jubilar për 40 dite përvojë pune shumën prej 631.50 € (150 % nga paga bazë e saj), të gjitha në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, me kamatë ligjore prej 8%

duke filluar nga dita e ushtrimit të padisë me datë 22.04.2020 e deri në pagesën definitive. Në pikën II (dy) të dispozitivit të aktgjykimit e ka detyruar të paditurën që paditëses t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 269.00 €, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën e të paditurës, të prishë aktgjykimin e atakuar dhe kërkesëpadia e paditëses të refuzohet si e pa bazuar në ligj, të prishë aktgjykimin e atakuar dhe çështjen ta kthejë në rigjykim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Paditësja nëpërmes të autorizuarit të saj ka paraqitur përgjigje në ankesë, duke e kundërshtuar në tërësi si të pabazuar ankesën e ushtruar nga e paditura, me propozim që Gjykata e Apelit të refuzoj si të pabazuar në ligj dhe prova faktike ankesën e të paditurës, meqë nuk ekzistojnë asnjëra nga shkaqet e paraqitura në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), ka gjetur se:

*Ankesa e të paditurës është e pa themeltë.*

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja N.B, përmes të autorizuarit të saj, me datë 22.04.2020, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, udhëtimit dhe shpërblimit jubilar, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit, Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, me arsyet sikurse në padi, të precizuar në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 09.02.2022, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura që paditëses për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit t'ia paguaj shumën prej 1,078.00 €, për shpenzimet e udhëtimit t'ia paguaj shumën prej 528.22 € dhe për shpërblim jubilar t'ia paguaj shumën prej 631.50 € apo në total shumën prej 2,237.72€, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas pranimit të përgjigjes në padi, ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin kryesor, ku pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë Aktgjykimin e atakuar C.nr.\*\*\*\*/20, të datës 01.03.2022, me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ndër të tjera ka theksuar se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, kjo vërtetohet edhe në bazë të kontratës së punës nr.\*\*\*, e datës 01.09.2015 dhe vërtetimit nr.32/2022, i datës 09.02.2022, të lëshuar nga SH.F.M.U "N.H" në fshatin D. Komuna e Gjilanit, sipas të cilit vërtetim është konstatuar se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune prej datës 07.02.1979 deri me datë 26.11.2020, çka do të thotë se jubileun 40 vjeçar e ka arritur me datë 07.02.2019 dhe se ka mbi 40 vite përvojë pune. Sipas vërtetimit nr.\*\*\*/2020, të datës 07.12.2020, të lëshuar nga shkolla e lartcekur, paditësja për periudhën prej datës 18.04.2017 deri

me datën 11.03.2020, ka qenë e pranishme në punë tek e paditura dhe atë 539 ditë pune. Padiësja gjatë kësaj periudhe ka shfrytëzuar transportin publik për vajtje shkuarje nga puna, e ku sipas vërtetimit pa numër të datës 03.06.2020 të NT "A.", çmimi i biletës së transportit publik është 0.70 € në një drejtim në relacionin Gjilan – D. ndërsa sipas vërtetimit mbi vendbanimin e padiësës, konstatohet se padiësja e ka vendbanimin në Gjilan dhe udhëton në relacionin Gjilan – D.. Sipas listës së pagave për muajin nëntor 2019, padiësja ka pagën bazë prej 421.00 €, ka përvojë pune 41 vjeçare dhe sipas librezës së anëtarësimit është anëtare e sindikatës. Tutje gjykata ka theksuar se padiësja për kompensimin e këtyre pagesave fillimisht i është drejtuar të paditurës me kërkesën e datës 30.03.2020, por e njëjta nuk ka marrë përgjigje. Andaj bazuar në dispozitat e nenit 35 paragrafi 5, 7 dhe 8 pikat 1, 2, 3, 4 dhe 6 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017, e lidhur dhe e nënshkruar nga Organizatat e të punësuarve si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, kërkesëpadia e padiësës është e bazuar, andaj vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Lidhur me bazën juridike gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitave të nenit 35 paragrafi 5, 7 dhe 8 pikat 1, 2, 3, 4 dhe 6 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017. Vendimin për kamatën gjykata e ka bazuar në dispozitat e nenit 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës e ka bazuar në dispozitat e nenit 453 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadiësë, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe atë mbi bazën e provave materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, nga të cilat prova konstatohet se padiësja është në marrëdhënie pune në SH.F.M.U "N.H" në fshatin D. Komuna e Gjilanit, në pozitën e edukatores, fakt i cili vërtetohet nga kontrata e punës me numër të protokollit \*\*, e datës 01.09.2015. Po ashtu gjendja faktike vërtetohet edhe nga vërtetimi mbi përvojën e punës me nr.\*\*/2022, të datës 09.02.2022, të lëshuar nga SH.F.M.U "N.H" në fshatin D. Komuna e Gjilanit, ku vërtetohet se padiësja është në marrëdhënie pune prej datës 07.02.1979 deri me datë 26.11.2020, çka do të thotë se jubileun 40 vjeçar e ka arritur me datë 07.02.2019 dhe se ka mbi 40 vite përvojë pune. Sipas vërtetimit nr.194/2020, të datës 07.12.2020, të lëshuar nga shkolla e lartcekur, vërtetohet fakti se padiësja për periudhën prej datës 18.04.2017 deri me datën 11.03.2020, ka qenë e pranishme në punë tek e paditura dhe atë 539 ditë pune. Padiësja

gjatë kësaj periudhe ka shfrytëzuar transportin publik për vajtje shkuarje nga puna, e ku sipas vërtetimit pa numër të datës 03.06.2020 të NT “A.”, çmimi i biletës së transportit publik është 0.70 € në një drejtim në relacionin Gjilan – D. ndërsa sipas vërtetimit mbi vendbanimin e paditëses, konstatohet se paditësja e ka vendbanimin në Gjilan dhe udhëton në relacionin Gjilan – D.. Gjendja faktike po ashtu vërtetohet edhe sipas listës së pagave, ku për muajin nëntor 2019, paditësja ka pagën bazë prej 421.00 €, andaj bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, e njëjta drejtë ka vepruar duke i njohur shumat si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, konform detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë.

Pretendimi ankimor i të paditurës se e drejta e paditëses për të kërkuar kompensimin e pagave jubilarë është parashkruar, sipas gjykatës ankimore ky pretendim është i paqëndrueshëm për faktin se paditësja ka parashtruar padinë në gjykatë me datë 22.04.2020, ndërsa jubileun e katërt (40 vite përvojë pune) e ka arritur me datë 07.02.2019, kjo bazuar në vërtetimin nr.32/2022, e datës 09.02.2022, të lëshuar nga SH.F.M.U “N.H” në fshatin D. Komuna e Gjilanit, ku konstatohet se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura prej datës 07.02.1979 e deri me datën 26.11.2020, qo do të thotë se jubileun e katërt (40 vite përvojë pune) e ka arritur me datë 07.02.2019, do të thotë në kohën kur ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit, e cila ka hyrë në fuqi prej datës 18.04.2017. Në këtë kontekst nuk pranohet pretendimi i të paditurës për parashkrimin e kërkesës, konform dispozitave të nenit 87 të Ligjit të Punës, e që në këtë rast nuk ka kaluar ky afat.

Pretendimi ankimor i të paditurës sa i përket kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit, se paditësja nuk ka ofruar kurrfarë dëshmie se ka pasur shpenzime me rastin e udhëtimit në relacionin për të cilën kërkon kompensim, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit ky pretendim është i paqëndrueshëm, ngase vet fakti i pakontestuar se paditësja është në marrëdhënie pune në SH.F.M.U “N.H” në fshatin D. Komuna e Gjilanit, në pozitën e edukatores, ndërsa jeton në Gjilan, fakt i cili është vërtetuar në bazë të certifikatës së vendbanimit me nr. serik B\*\*\*\*\*, të datës 09.12.2019, ku si adresë e paditëses figuron rruga “M.I”, Nr\*\*\*, në Gjilan, andaj kjo e argumenton faktin se paditësja nga vendbanimi i saj udhëton në vendin e punës.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurës se e njëjta nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit dhe se rrjedhimisht nuk ka marrë obligimet për të zbatuar këtë kontratë, për faktin se sipas vlerësimit të gjykatës ankimore me dispozitën e nenit 2 paragrafi 1 pika 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë përcaktohet se: “1. Dispozitat e kësaj kontrate kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të arsimit para universitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”, ndërsa me nën paragrafin 1.2 përcaktohet se: “Dispozitat e kësaj kontrate, janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativoarsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”.

Gjykata e Apelit, mori parasysh pretendimin ankimor të të paditurës lidhur me faktin se Kontrata Kolektive e Arsimit nuk është obligative për të paditurën, për arsye se nuk janë përmbushur kushtet e parapara me nenin 46 të kësaj Kontrate, meqenëse nënshkruesit e kësaj kontrate siç janë MASHT-i, SBASHK-u dhe Ministria e Financave nuk janë angazhuar asnjëherë për zbatimin e dispozitave që janë implikime financiare. Lidhur me këto pretendime, Gjykata e

Apelit vlerëson se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, rrjedh se obligimi për përmbushjen e të drejtave të të punësuarve të parapara me këtë Kontratë, përfshirë të drejtën për kompensim të shpenzimeve të ushqimit, i takon pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan. Në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditëses, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet në tërësi si e pa bazuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, kjo për arsyeje se me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L212 të datës 01.11.2010, përcaktohet se “*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në mes: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) të nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës. Me paragrafin 5 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive*”. Me nenin 35 par. 8 të Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, përcaktohet se: “*...Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, 8.1. për 10 vjet të përvojës në punë në vlerë të 50 % të një page bazë, 8.2. për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë të 75% të një page bazë, 8.3. për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë, 8.4. për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë të 150 % të një page bazë, 8.5. Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuarit ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterëve përkatëse, 8.6. Shpërblimi jubilar paguhet në rastin e 7 Marsit të çdo viti... ”. Me nenin 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, përcaktohet se: “*...Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore... ”. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”. Po ashtu me nenin 35 paragrafi 5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila ka hyrë në fuqi më 18.04.2017, parashihet se: “*Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban ”.***

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses, duke vendosur decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, me të drejtë është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT), e cila kontratë ka qenë në fuqi me rastin e lindjes të së drejtës për të parashtruar kërkesën për kompensimin e shpërblimit jubilar, shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë, si dhe shpenzimet e udhëtimit, që nënkupton se kjo Kontratë shërben si akt nga i cili buron themelësia e kërkesëpadisë.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridiko - civil, ndaj

paditëseve në emër të pagesës për kompensimin e shpërblimit jubilar, për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*.

Në këtë drejtim edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitat e LPK-së, dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifat për shpenzime gjyqësore. E drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë edhe sa i përket kërkesës aksesore përkitazi me kamatën.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat pretendime nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura, Gjykata e Apelit gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par. 1 pika d) të LPK-së, lidhur me neni 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.3441/2022, me datë 19.03.2025.

Bashkëpunëtorja profesionale  
Xhennet Shantir

Kryetarja e kolegjit,  
Halide Reka

Numri i lëndës: 2020:056774  
Datë: 21.03.2025  
Numri i dokumentit: 07024561